



**Prishtinë: 16.05.2014**  
**Kodi i ZRRE-së: V\_627\_2014**

**Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji**

**Duke u bazuar në:**

- Nenin 8, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.6, neni 14, paragrafi 2, nën-paragrafi 2.14 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr.03/L—185);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK\_V\_1084\_01\_14**;
- Ankesa e KEDS-it e datës 28.04.2014.

**në seancën e mbajtur më datë 16 maj 2014, nxorri këtë:**

**V E N D I M**

- I REFUZOHET** ankesa e KEDS-it ndaj vendimit të DMK-së për konsumatorin K. Q., me shifër të konsumatorit: DFE – 18002) nga Prishtina ndaj vendimit të DMK-së, si në arsyet e paraqitura në arsyetimin e këtij vendimi.
- II MBETET në fuqi** vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve nr. ZRRE/DMK\_V\_1110\_03\_14 i datës 31.03.2014.

**Arsyetim**

Departamenti për Faturim i KEDS me datë 04.11.2013 e ka ngarkuar konsumatorin me faturë mujore të energjisë elektrike për muajin tetor 2013 vetëm me taksë fikse prej 2.63€, pa shpenzim të energjisë elektrike; me datë 04.12.2013 Departamenti për Faturim i KEDS e ka ngarkuar konsumatorin me faturë mujore të energjisë elektrike për muajin nëntor 2013 me shpenzim prej 579 kWh apo e shprehur financiarisht në vlerë prej 37.82 €; me datë 02.01.2014 Departamenti për Faturim i KEDS e ka ngarkuar konsumatorin me faturë mujore të energjisë elektrike për muajin dhjetor 2013 vetëm me taksë fikse prej 2.63€, pa shpenzim të energjisë elektrike dhe me datë 21.01.2014 Departamenti i Faturimit në KEDS e ka ngarkuar konsumatorin me faturë mujore të energjisë elektrike për muajin janar 2014 me shpenzim prej 1,997 kWh apo e shprehur financiarisht në vlerë prej 169.88 €.

Pas këtyre faturave të energjisë elektrike konsumatori me datë 21.01.2014 ka parashtruar ankesë zyrtare në KEDS duke kërkuar shpërndarje të shpenzimit të faturës së janarit 2014.

Pas kësaj anese të konsumatorit punëtorët e autorizuar të KEK-ut për inspektimin e pikave matëse me datë 24.01.2014 kanë inspektuar pikën matëse të konsumatorit me shifër DFE – 18002 dhe gjatë inspektimit kanë konstatuar se gjendja e njehsorit elektrik nr. 12738109 është: TL=9866 kWh (tarifa e lartë) dhe TU=5698 kWh (tarifa e ulët).

Konsumatori pas marrjes së përgjigjes së KEK-ut me datë 14.02.2014 ka parashtruar ankesë në Departamentin për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE duke kontestuar borxhin e faturuar për muajin 01/2014. DMK pas parashtrimit të ankesës së konsumatorit ka bërë shqyrtimin e ankesës dhe



me datë 31.03.2014 ka nxjerr vendim duke e **aprovuar** ankesën e konsumatorit dhe duke kërkuar nga KEDS që: 1) të shkarkoj konsumatorin me shifër DFE – 18002 nga nr. 26607 dhe 26608 e datës 04.02.2014 në vlerë (-3.74€) dhe (-21.18€); 2) të korrigjoj konsumatorin me shifër DFE – 18002 për faturat nga muaji 08/2013 – 01/2014, ashtu që të bëjë shpërndarjen proporcionale të shpenzimit të energjisë elektrike nga muaji 08/2013 – 01/2014.

Baza e kundërshtimeve të KEDS-it të theksuara në ankesë është se DMK e ZRRE-së gabimisht ka bërë vlerësimin e provave dhe shkresave të prezantuara të lëndës për faktin se në bazë të shënimeve që disponon KEDS-i, korrigjimet janë të sakta. Muaji 8 dhe 9 nuk është përfshirë në korrigjime me arsyetimin se korrigjimi rezulton zero me çka konsumatori nuk është dëmtuar në faturim me mesatare të 8 - 2013. Gjithashtu në ankesë theksohet se KEDS-i është i obliguar që konsumatorin ta lexoi me rregull dhe njëherit t'ia dorëzoi faturën, çka me rastin konkret është vepruar drejt.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 16 maj 2014 ka analizuar të gjitha dëshmitë e paraqitura nga ana e KEDS-it, përkatësisht bazën e kundërshtimit dhe pas vlerësimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës ka vlerësuar se argumentet e prezantuara nga ana e KEDS nuk janë bindëse për faktin se me asnjë provë nuk ka argumentuar se DMK ka bërë gabimisht vlerësimin e provave gjatë vendosjes së kësaj çështje. Arsyet e theksuara në ankesë janë se në bazë të dëshmive të propozuara korrigjimet janë të sakta. Bordi i ZRRE-së ka konstatuar se KEDS nga muaji 08/2013 e deri më 01/2014 nuk i respektuar dispozitat ligjore të rregullave dhe procedurave, nuk ka bërë lexim të rregullt, gjithashtu korrigjimin nuk e ka bërë të saktë pasi që korrigjimi është dashtë të bëhet duke bërë shpërndarjen proporcionale të shpenzimit nga muaji 08/2013 e deri më 01/2014 në vlerë prej (-49.19€).

Bordi i ZRRE-së ka vlerësuar se KEDS në ankesën e tij nuk ka prezantuar asnjë provë të vetme me të cilën e vërteton faktin se vendimi i DMK-së nuk është vendim i drejtë dhe i bazuar në ligj, andaj si të tilla nuk paraqesin bazë të mjaftueshme për prishjen e këtij vendimi.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 16.05.2014 ka analizuar ankesën e KEDS dhe vendimin e nxjerr nga DMK nr. ZRRE/DMK\_V\_1110\_03\_14, dhe pas analizimit të hollësishëm të të gjitha dëshmive tjera të prezantuara në shkresat e lëndës ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

- III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versionin në gjuhën shqipe.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.



**Këshillë Juridike:** Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimet të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

#### **Bordi i ZRRE-së**

---

Enver Halimi, kryesues

---

Merita Kostari, anëtare

---

Krenar Bujupi, anëtar